



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 133

7 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8284 datë 5.8.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5853
Vendim i KM nr. 620, datë 24.7.2013	Për miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure shtesë të kontratave me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në bllloqet A-B dhe D-E, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “Petromanas Albania GmbH”..... 5853
Vendim i KM nr. 621, datë 24.7.2013	Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit për dhënien me qira, me çmimin 1 (një) euro kontrata, të sipërfaqes prej 103 550 m ² në administrim të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan..... 5860
Vendim i KM nr. 624, datë 24.7.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar..... 5861
Vendim i KM nr. 625, datë 24.7.2013	Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë..... 5863
Vendim i KM nr. 626, datë 30.7.2013	Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të akorduara nëpërmjet marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale (faza 2)”..... 5882
Vendim i KM nr. 627, datë 30.7.2013	Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve të akorduara nëpërmjet marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”..... 5883

DEKRET
Nr. 8284, datë 5.8.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministrisë të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Kreshnik Gani Ibrahim
2. Erkan Serbüent Ömer Tabak
3. Mehmet Ertuğrul Ahmet Fevzi Gürler
4. Nurie Kujtim Çani (Rustemi)
5. Malush Sahit Abrashi
6. Nevedet Riza Abrashi
7. Xhevat Jetullah Basha
8. Mire Ramadan Basha

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 620, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE HIDROKARBURE SHITESË TË KONTRATAVE
ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE NË SHQIPËRI, NË TOKË, NË BLOQET A-B DHE D-E,
NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, E
PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE (AKBN)
DHE “PETROMANAS ALBANIA GMBH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr. 7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjeve hidrokarbure shtesë të kontratave me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në bloqet A-B dhe D-E,



ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “Petromanas Albania GmbH”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

MARRËVESHJE HIDROKARBURE SHITESË

**E KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E
HIDROKARBUREVE**

**MIDIS MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS SË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA E BURIMEVE NATYRORE DHE PETROMANAS
ALBANIA GMBH PËR BLOQET A-B (NË TOKË) SHQIPËRI**

Kjo marrëveshje hidrokarbure shtesë (më poshtë e quajtur “MHS”) është bërë dhe hyn në fuqi sot më..... nga dhe, midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (më poshtë e quajtur “AKBN”) dhe “Petromanas Albania GmbH” (më poshtë i quajtur “Kontraktor”), “AKBN” dhe “Kontraktor” më poshtë do të quhen si “Palë”.

Ndërsa kontrata me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet A-B (më poshtë e quajtur “KNPKZHP”) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “DWM Petroleum AG”, është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 7.11.2007.

Ndërsa ka hyrë në fuqi ligji nr. 10 280, datë 20.5.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”. Ky ligj ka vendosur detyrimin që: “çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë.”

Ndërsa Kontraktori ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure në zonën e kontratës; dhe

Ndërsa Palët bien dakord që aprovimi për këto shtesa dhe ndryshime është subjekt i marrëveshjes unanime të palëve;

Prandaj, duke marrë në konsideratë kushtet dhe marrëveshjet reciproke të përfshira këtu, Palët bien dakord të ndryshojnë disa nga dispozitat e KNPZHP.

QËLLIMI

Kjo MHS ka për qëllim që së bashku me KNPZHP, të përfshijnë termat dhe kushtet që janë vendosur nga ligjet specifike, të cilat kanë hyrë në fuqi pas nënshkrimit të MH.

Me anë të kësaj, njihet dhe bihet dakord që të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës do të udhëhiqen nga dispozitat e KNPZHP, siç janë ndryshuar me anë të kësaj MHS.

HYRJE

1. Kudo në përmbajtjen e kontratës dhe në anekset e saj emërtimi i kompanisë “DWM Petroleum AG” zëvendësohet me “Petromanas Albania GmbH”.

2. Titulli “Kontratë me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet “A-B” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe DWM Petroleum AG”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kontratë me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë në blloqet “A-B” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe PETROMANAS ALBANIA GMBH”.

3. Në preambulën e kontratës, në fund të listës së ligjeve dhe akteve nënligjore shtohen paragrafët me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

“Ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 1 Përcaktime

Termat dhe përcaktimet e përdorur në këtë MHS do të kenë të njëjtin kuptim siç është specifikuar në KNPKZHP me ndryshimet e mëposhtme:

Pas pikës 1.66 shtohet pika 1.67 me përmbajtje si vijon:

1.67 “Renta minerare” do të thotë taksa e përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

Neni 7

Mbulimi i kostove dhe i shpenzimeve, ndarja e prodhimit, hidrokarburet fitim dhe kostot e parimbursueshme

Pika 7.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.1 Pjesa e hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si hidrokarbure për mbulim kostoje, është njëqind (100%) për qind e hidrokarbureve të disponueshme, pas heqjes së rentës minerare dhe grantit për qeverinë, siç përshkruhet në paragrafin 7.7.

Kontraktori ka të drejtë t’i marrë hidrokarburet për mbulimin e kostos në natyrë, t’i eksportojë lirisht dhe t’i përdorë ato.”.

Pika 7.6, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.6 Në lidhje me çdo muaj kalendarik, të gjitha hidrokarburet e disponueshme të mbetura pas zbritjes së rentës minerare, grantit për qeverinë dhe të të gjitha shpenzimeve dhe kostove të mbulueshme sipas kësaj kontrate për atë muaj kalendarik, do të jenë hidrokarbure fitim dhe në përputhje me paragrafin 7.5 më sipër do të merren në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponohen lirshëm dhe veçmas nëpërmjet eksportimit apo në mënyra të tjera, me riskun, koston dhe shpenzimet përkatëse të tyre nga AKBN-ja dhe Kontraktori, siç është e aplikueshme.”.

Pika 7.7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.7 AKBN-ja ka të drejtë të marrë grantin e qeverisë nga prodhimi, i cili do të jetë i barabartë më:

Faktori R	Granti për qeverinë
$0 < R \leq 1.5$	0%
$1.5 < R \leq 2.0$	2.5%
$2.0 < R$	5%

Neni 8 Gazi

Pika 8.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.1 Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e këtij neni 8 të aneksit D dhe do të respektohen dispozitat e ligjit nr. 9946, datë 3.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.



Neni 9

Tatimet dhe taksat shqiptare

Në pikën 9.1 në paragrafin e parë, hiqet fjalia e fundit dhe shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon:

“9.1 Kontraktori do të paguajë rentën minerare në masën 10% të prodhimit të shitur, në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Pika 9.4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.4 Në qoftë se gjatë zbatimit të kësaj kontrate, Kontraktori mund të përbëhet nga më shumë se një njësi, tatimi shqiptar mbi fitimin e secilit prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguhet në para¹ tek autoriteti përkatës i qeverisë shqiptare, sipas sugjerimit të AKBN-së, në përputhje me ligjet e aplikueshme shqiptare, rregullat dhe procedurën e mëposhtme:”

Pika 9.4.1 hiqet.

Pika 9.4.2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.4.2 Secili prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguajnë tatimin shqiptar mbi fitimin për çdo vit kalendarik, në para brenda gjashtëdhjetë {60} ditësh nga paraqitja tek AKBN-ja të situacionit të mbulimit të kostos për vitin përkatës kalendarik, siç kërkohet nga neni III i Procedurës së Kontabilitetit. Paga e rentës minerare do të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.”.

Pikat 9.4.3, 9.4.4 dhe pika 9.4.5 hiqen.

Pika 9.5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.5 Përveç rentës minerare dhe tatimit shqiptar mbi fitimin siç përshkruhet më sipër, çdo ent që përbën Kontraktorin, shoqëritë përkatëse filiale të tyre dhe personeli i huaj do të përjashtohen nga taksat, tarifatat, tatimet, detyrimet dhe pagesat shqiptare të çfarë do lloj natyre, duke përfshirë por pa u kufizuar në tatimin mbi vlerën e shtuar në përputhje me ligjin e TVSH-së dhe taksën akcizës në përputhje me ligjin mbi taksën e akcizës, të pagueshme në Shqipëri, në lidhje me gjithë aktivitetet që lidhen me operacionet hidrokarbure. Ky përjashtim nuk përfshin pagesat normale portuale, të magazinimit dhe postale dhe detyrime të tjera të ngjashme klientele me aplikim të përgjithshëm për shërbimet faktike të kryera.”.

ANEKSI A

PËRSHKRIMI ZONËS SË KONTRATËS

1 Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. 41° 20' 00" N “Ndërprerja e gjerësisë gjeografike me vijën bregdetare”.”.

Në dëshmi këtu, Palët kanë ekzekutuar këtë marrëveshje hidrokarbure shtesë që do të hyjë në fuqi në datën kur vendimi i Këshillit të Ministrave aprovon hyrjen e saj në fuqi.

¹ Paga në para do të realizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.

MARRËVESHJE HIDROKARBURE SHITESË
E KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN
E HIDROKARBUREVE MIDIS MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA E
BURIMEVE NATYRORE DHE PETROMAS ALBANIA GMBH PËR BLOQET D-E (NËN
TOKË) SHQIPËRI

Kjo marrëveshje hidrokarbure shtesë (më poshtë e quajtur “MHS) është bërë dhe hyn në fuqi sot më..... nga dhe, midis Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (më poshtë e quajtur “AKBN”) dhe “Petromanas Albania GmbH” (më poshtë i quajtur “Kontraktor”), “AKBN” dhe “Kontraktor” më poshtë do të quhen si “Palë”.

Ndërsa kontrata me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet D-E (më poshtë e quajtur “KNPKZHP”) ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe “DWM Petroleum AG”, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 796, datë 7.11.2007.

Ndërsa ka hyrë në fuqi ligji nr. 10 280, datë 20.5.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”. Ky ligj ka vendosur detyrimin që: “çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga/mbi/dhe nëntoka e territorit të Republikës së Shqipërisë.”.

Ndërsa Kontraktori ka të drejtën të kryejë operacione hidrokarbure në zonën e kontratës; dhe

Ndërsa Palët bien dakord që aprovimi për këto shtesa dhe ndryshime është subjekt i marrëveshjes unanime të palëve;

Prandaj, duke marrë në konsideratë kushtet dhe marrëveshjet reciproke të përfshira këtu, Palët bien dakord të ndryshojnë disa nga dispozitat e KNPKZHP.

QËLLIMI

Kjo MHS ka për qëllim që së bashku me KNPKZHP, të përfshijnë termat dhe kushtet që janë vendosur nga ligjet specifike të cilat kanë hyrë në fuqi pas nënshkrimit të MH.

Me anë të kësaj njihet dhe bihet dakord që të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës do të udhëhiqen nga dispozitat e KNPKZHP, siç janë ndryshuar me anë të kësaj MHS.

HYRJE

1. Kudo në përmbajtjen e kontratës dhe në anekset e saj, emërtimi kompanisë “DWM Petroleum AG” zëvendësohet me “Petromanas Albania GmbH”.

2. Titulli i “Kontratës me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë, në blloqet “D-E” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe DWM Petroleum AG”, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kontratë me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri, në tokë në blloqet “D-E” ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Shqipërisë, e përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe PETROMANAS ALBANIA GMBH”.

3. Në preambulën e kontratës, në fund të listës së ligjeve dhe akteve nënligjore shtohen paragrafët me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.



Neni 1 Përcaktime

Termat dhe përcaktimet e përdorur në këtë MHS do të kenë të njëjtin kuptim, siç është specifikuar në KNPZHP me ndryshimet e mëposhtme:

Pas pikës 1. 66 shtohet pika 1.67 me përmbajtjen si vijon:

“1.67 “Rentë minerare” do të thotë taksë e përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.”.

Neni 4

Periudha e kërkimit, programi i punës dhe shpenzimet e parashikuara

Pas fjalisë së fundit të pikës 4.1.2, shtohet një paragraf me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“4.1.2 Përveç sa parashikohet në këtë pikë, afati i zgjatjes së “Periudhës së dytë të kërkimit” do të pezullohet, duke filluar nga data 1.7.2012 deri në datë 30.6.2013. Kjo periudhë pezullimi ndërpret për një vit afatin e periudhës së dytë të kërkimit, e cila rifillon pas datës së përfundimit të pezullimit.

Garancia bankare e depozituar nga Kontraktori (siç parashikohet në aneksin E bashkëngjitur KNPZHP për blloqet D-E) do të vazhdojë të jetë e vlefshme dhe data e përfundimit të saj do të zgjatet për një vit).

Neni 7

Mbulimi i kostove dhe i shpenzimeve, ndarja e prodhimit, hidrokarburet fitim dhe kostot e parimbursueshme

Pika 7.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.1 Pjesa e hidrokarbureve të disponueshme që do të përcaktohen si hidrokarbure për mbulim kostoje, është njëqind (100%) për qind e hidrokarbureve të disponueshme, pas heqjes së rentës minerare dhe grantit për qeverinë, siç përshkruhet në paragrafin 7.7. Kontraktori ka të drejtë t’i marrë hidrokarburet për mbulimin e kostos në natyrë, t’i eksportojë lirisht dhe t’i përdorë ato”.

Pika 7 .6, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.6 Në lidhje me çdo muaj kalendarik, të gjitha hidrokarburet e disponueshme, të mbetura pas zbritjes së rentës minerare, grantit për qeverinë dhe të të gjitha shpenzimeve dhe kostove të mbulueshme sipas kësaj kontrate për atë muaj kalendarik, do të jenë hidrokarbure fitim dhe në përputhje me paragrafin 7.5 më sipër, do të merren në natyrë në pikën e matjes dhe do të disponohen lirshëm dhe veçmas nëpërmjet eksportimit apo në mënyra të tjera, me riskun, koston dhe shpenzimet përkatëse të tyre nga AKBN-ja dhe Kontraktori, siç është e aplikueshme.”.

Pika 7.7 ndryshohet si më poshtë vijon:

“7.7 AKBN-ja ka të drejtë të marrë grantin e qeverisë nga prodhimi, i cili do të jetë i barabartë me:

Faktori R	Granti për qeverinë
$0 < R \leq 1.5$	0%
$1.5 < R \leq 2.0$	2.5%
$2.0 < R$	5%”

Neni 8 **Gazi**

Pika 8.1, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.1 Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e këtij neni 8 të aneksit D dhe do të respektohen dispozitat e ligjit nr. 9946, datë 3.6.2008 “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 9 **Tatimet dhe taksat shqiptare**

Në pikën 9.1 në paragrafin e parë, hiqet fjalia e fundit dhe shtohet një paragraf i ri me përmbajtjen si vijon:

“9.1 Kontraktori do të paguajë rentën minerare në masën 10% të prodhimit të shitur, në përputhje me ligjin nr. 9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”.

Pika 9.4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.4 Në qoftë së gjatë zbatimit të kësaj kontrate, Kontraktori mund të përbëhet nga më shumë se një njësi, tatimi shqiptar mbi fitimin e secilit prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguhet në para² tek autoriteti përkatës i qeverisë shqiptare, sipas sugjerimit të AKBN-së, në përputhje me ligjet e aplikueshme shqiptare, rregullat dhe procedurën e mëposhtme:”

Pika 9.4.1 hiqet.

Pika 9.4.2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.4.2 Secila prej enteve që përbëjnë Kontraktorin do të paguajnë tatimin shqiptar mbi fitimin për çdo vit kalendarik, në para brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga paraqitja tek AKBN-ja të situacionit të mbulimit të kostos për vitin përkatës kalendarik, siç kërkohet nga neni III i Procedurës së Kontabilitetit. Paguesa e rentës minerare do të bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar.”.

Pikat 9.4.3, 9.4.4 dhe pika 9.4.5 hiqen.

Pika 9.5 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9.5 Përveç rentës minerare dhe tatimit shqiptar mbi fitimin, siç përshkruhet më sipër, çdo ent që përbën Kontraktorin, shoqëritë përkatëse filiale të tyre dhe personeli i huaj do të përjashtohen nga taksat, tarifat, tatimet, detyrimet dhe pagesat shqiptare të çfarëdolloj natyre, duke përfshirë, por pa u kufizuar në tatimin mbi vlerën e shtuar në përputhje me ligjin e TVSH-së dhe taksën e akcizës në përputhje me ligjin mbi taksën e akcizës, të pagueshme në Shqipëri, në lidhje me të gjitha aktivitetet që lidhen me operacionet hidrokarbure. Ky përjashtim nuk përfshin pagesat normale portuale, të magazinimit dhe postale dhe detyrime të tjera të ngjashme klientele me aplikim të përgjithshëm për shërbimet faktike të kryera.”

Në dëshmi këtui, Palët kanë ekzekutuar këtë marrëveshje hidrokarbure shtesë që do të hyjë në fuqi në datën kur vendimi i Këshillit të Ministrave aprovon hyrjen e saj në fuqi.

² Paguesa në para do të bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar në fuqi.



VENDIM
Nr. 621, datë 24.7.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË KONKURRIMIT PËR DHËNIEN ME QIRA, ME
ÇMIMIN 1 (NJË) EURO KONTRATA, TË SIPËRFAQES PREJ 103 550 M² NË
ADMINISTRIM TË NDËRMARRJES SË PRODHIMIT TË ÇELIQEVE, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve” dhe të pikës 1 të kreut V të vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie me qira, me çmimin 1 (një) euro/kontrata, të pasurisë “Sipërfaqe e lirë prej 103 550 m², në Ndërmarrjen e Prodhimit të Çeliqueve, Elbasan”, nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

2. Për dhënie me qira të zbatohen procedurat e përcaktuara në kreun II dhe kreun V të vendimit nr. 529, datë 8.6.2011 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar.

3. Kriteret e konkurrimit për dhënie me qira të kësaj pasurie të jenë, si më poshtë vijon:

a) Pasuria jepet me qira, me qëllim zhvillimin e veprimtarive në fushën e industrisë përpunuese.

b) Nivelet e investimit që do të kryhen në këtë pasuri për zhvillimin e aktivitetit, të jenë në vlera mbi 10 (dhjetë) milionë euro.

4. Ofertat e pjesëmarrësve në konkurrim të vlerësohen me pikë, si më poshtë vijon:

a) Investimi 50 pikë

b) Punësimi 30 pikë

c) Koha e fillimit të punës 20 pikë.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 624, datë 24.7.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë të arsimit parauniversitar”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr. 194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2013, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi për politikat e pagave për vitin 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1
STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE			Shtesa e pozicionit
		Paga individuale			
		Paga e grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikimin (SHK)	
		1	2	3	4
1	Drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore Drejtor i konvikteve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	53000
2	Drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	52500
3	Drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	52000



4	Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me mbi 700 nxënës Përgjegjës i bazës prodhuese Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë Zëvendës drejtor në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	47500
5	Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me 301 deri në 700 nxënës				47000
6	Zëvendës drejtor i shkollës së mesme me deri në 300 nxënës				46500
7	Drejtor i Qendrës Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	44500
8	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me mbi 700 nxënës	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	43500
9	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me 301 deri në 700 nxënës	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	43000
10	Drejtor i shkollës 9-vjeçare me deri në 300 nxënës	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	42500
11	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV. Përgjegjës (kryemësues) i shkollës me klasë kolektive Zëvendës drejtor i shkollës 9-vjeçare	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	41000
12	Drejtor i kopshtit me ushqim	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	39500
13	Përgjegjës sektori në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	39000
14	Drejtor i kopshtit pa ushqim	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	36500
15	Mësues në shkollat e mesme Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë Mësues në shkollat me probleme të larta mendore	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	38500
16	Instruktur në Qendrën Kulturore të Fëmijëve	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	36500
17	Mësues në ciklin e lartë në shkollat 9-vjeçare	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	35500
18	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare Edukator konvikti Kujdestar konvikti	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	33500
19	Edukator në kopsht fëmijësh	1	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	31500
20	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare Edukator konvikti Kujdestar konvikti	2	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	31500
21	Edukator në kopsht fëmijësh	2	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	28500
22	Mësues në ciklin e ulët në shkollat 9-vjeçare	3	2% e PG	5 % e PG 10% e PG 20% e PG	28500

VENDIM
Nr. 625, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS SË ZHVILLIMIT TË SHËRBIMEVE
POSTARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Vendimi nr. 539, datë 1.8.2003 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit të politikës së zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.
 3. Ngarkohet Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**DOKUMENTI I POLITIKËS PËR ZHVILLIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

HYRJE

Ky dokument prezanton politikën sektoriale për zhvillimin e shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë për periudhën afatmesme afatgjatë. Sektori postar është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë shqiptare. Qëllimi i këtij dokumenti të ri të politikës për zhvillimin e sektorit postar është përcaktimi i objektivave të zhvillimit të shërbimeve dhe tregut postar, përcaktimi i hapave për liberalizimin e mëtejshëm të tij në linjë me zhvillimet në tregun postar në Bashkimin Europian dhe atë global.

Ky dokument do të zëvendësojë dokumentin e parë të politikës të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 1.8.2003 “Për miratimin e dokumentit të zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë”, dhe synon të reflektojë në mënyrë adekuate zhvillimet që kanë ndodhur në këtë treg si ato teknologjike dhe zhvillimet globale, duke marrë në konsideratë rrethanat e tregut shqiptar.

Dokumenti bazohet në eksperiencën e Bashkimit Europian dhe në Strategjinë globale të zhvillimit të shërbimeve postare të miratuar në Kongresin e Bashkimit të Përbotshëm Postar, UPU-së të zhvilluar në vitin 2012.

Dokumenti i ri i politikave është hartuar pas një studimi të direktivave postare të BE-së (97/67/EC, 2002/39/EC dhe 2008/6/EC), si dhe pas një analize të situatës dhe kuadrit ligjor ekzistues shqiptar me synim harmonizimin e tij me *acquis communautaire* të BE-së në përputhje me angazhimet në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit. Sikurse synimi kryesor i *acquis communautaire* në fushën e aktiviteteve postare është një kuadër rregullator për hapjen në mënyrë graduale dhe të kontrolluar të tregut postar për konkurrencë të lirë të tregut dhe për të siguruar vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve postare universale, hapja e plotë e tregut postar është një objektiv i rëndësishëm i përcaktuar në këtë dokument.



Në dokument paraqitet progresi i bërë në sektorin postar, sfidat që shfaqen për zhvillimin e qëndrueshëm në një treg të hapur për konkurrencë, duke nënvizuar rëndësinë e vijimit të sigurimit të shërbimit universal me hapjen e tregut. Kuadri i ri ligjor e rregullator përbëjnë një nevojë për realizimin e objektivave të liberalizimit të plotë e shoqëruar me përcaktime të qarta për llojet e shërbimeve postare, shërbimin universal dhe zonën e rezervuar, parimet e vendosjes së tarifave, sigurimin e konkurrencës në treg përmes transparencës së financimit dhe ndarjes së sistemit të llogarive, cilësia e shërbimit universal, harmonizimi i standardeve teknike etj. Pjesë e objektivave të këtij dokumenti janë dhe angazhimet në nivel ndërkombëtar në përputhje me strategjinë globale për zhvillimin postar të miratuar nga Bashkimi i Përbotshëm Postar, UPU.

I. Analizë e situatës aktuale

I.1 Të përgjithshme

Zhvillimet në tregun e shërbimit postar në Republikën e Shqipërisë janë paraprirë nga politika e zhvillimit të shërbimeve postare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 539, datë 1.8.2003. Ky dokument përcaktoi objektivat kryesorë të politikës së zhvillimit të shërbimit postar për periudhën 2003-2009. Në këtë dokument u përcaktua, gjithashtu, se liberalizimi i sektorit postar do të kryhej në mënyrë graduale.

Që nga miratimi i dokumentit të politikave postare në vitin 2003, në tregun postar kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të rëndësishme që përfshijnë disa ndryshime në kuadrin ligjor, si dhe ndarjen e funksioneve rregullatore nga ato të politikëbërjes. Ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në tregun postar në drejtim të zhvillimeve të shërbimeve postare të ofruara në veçanti nga operatori publik postar. Një numër i madh objektivash të vendosur në këtë dokument janë realizuar me sukses, si:

- ristrukturimi i administratës së operatorit publik postar;
- përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator;
- sigurimi i shërbimit bazë postar;
- futja e shërbimeve të reja postare;
- zhvillimi i infrastrukturës postare;
- harmonizimi i standardeve kombëtare me ato të Bashkimit Europian dhe të UPU-së;
- futja e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit;
- zhvillimi i burimeve njerëzore etj.

Në drejtim të liberalizimit të tregut, hapi i parë i liberalizimit për reduktimin e zonës së rezervuar nga 1000 g në 100 g, si dhe rregullimi i çmimit limit u krye në vitin 2004 sipas parashikimeve në dokumentin e politikës së miratuar në vitin 2003. Liberalizimi i mëtejshëm i tregut postar për të kaluar në një zonë të rezervuar nga 100 g në 50 g, si dhe hapja e plotë e tregut ishte parashikuar të zhvillohej sipas hapave të liberalizimit të sektorit postar në vendet e Bashkimit Europian.

Sikurse në disa vende të BE-së, si: Rumania, Greqia, Bullgaria, ku liberalizimi i sektorit postar nuk është përfunduar ende dhe në vendin tonë, liberalizimi i plotë i sektorit postar për reduktimin dhe më pas heqjen e zonës së rezervuar nuk është përfunduar. Kjo ka qenë e lidhur me faktin që procesi i hapjes së plotë të tregut postar duhet të shoqërohet dhe me ndryshime ligjore përfshirë mënyrën e sigurimit të shërbimit bazë postar.

I.2 Kuadri ligjor dhe rregullator për shërbimet postare

Aktualisht tregu postar rregullohet me ligjin nr. 8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (këtu e më poshtë ligji nr. 8530/1999). Ky ligj rregullon ofrimin e veprimtarive postare, kushtet e kryerjes së shërbimeve postare, dhe përcakton rolin e shtetit në sektorin postar, si dhe të drejtat dhe detyrat përkatëse të operatorit publik, ofruesve të shërbimeve postare dhe të përdoruesve. Ligji nr. 8530/1999 është në linjë me direktivën 97/67/EC dhe direktivën 2002/39/EC, por nuk reflekton ndryshimet e direktivës së fundit postare 2008/6/EC.

Kuadri institucional për shërbimet postare përbëhet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe të Komunikimit, si politikëbërës dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si organi rregullator i pavarur.

Ndryshimet institucionale për ndarjen e detyrave të politikë bërësit nga rregullimi u realizuan me amendimin e ligjit nr. 8530/1999 në vitin 2009. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ushtron aktivitetin në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 8530/1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ndryshimet ligjore dhe kalimi i detyrave rregullatore tek AKEP-i, nxorën si nevojë krijimin dhe përshtatjen e strukturës së AKEP-it për përmbushjen e detyrave të rregullimit postar. Aktualisht detyrat rregullatore për sektorin postar, AKEP-i i kryen me strukturën ekzistuese të miratuar para ndryshimeve në ligjin nr. 8530/1999.

I.3 Zhvillimet në tregun postar shqiptar

Zhvillimi i tregut postar shqiptar në vitet e fundit është nxitur nga avancimet teknologjike dhe rritja e konkurrencës. Masat reformuese të ndërmarra kanë sjellë, gjithashtu, zhvillime të ndjeshme pozitive në sektorin postar në vend, përmes rritjes së cilësisë, shërbimeve më të mira dhe më eficente.

Në sektorin postar, ushtron veprimtarinë “Posta Shqiptare” sh.a. si operatori publik postar që është i ngarkuar për sigurimin e shërbimit bazë postar dhe që gëzon të drejtat e zonës së rezervuar. Në tregun postar ushtrojnë veprimtarinë dhe 11 ofrues të tjerë të shërbimeve postare të pajisur nga AKEP-i me licencë të përgjithshme për shërbimet postare.

Bazuar në të dhënat e raportuara për vitin 2012 nga operatori publik dhe ofruesit e shërbimeve postare, tregu postar në vend llogaritet në 2,855,658,446 lekë. Pjesën më të madhe në këtë treg e zotëron Posta Shqiptare me një total të ardhurash për vitin 2012 në 1,898,214,000 lekë. Në grafikun e mëposhtëm jepet shpërndarja e pjesëve të tregut postar bazuar në të ardhurat për vitin 2012. Posta Shqiptare zotëron 67% të tregut e pasuar nga DHL me 13% të tregut dhe me pas AC, TNT me 5% dhe unitet transport me 4%.




Fig. 1: Pjesët e tregut postar bazuar në të ardhurat e realizuara për vitin 2012

Numri total i zyrave postare në vend në fund të vitit 2012, ishte 839 ku pjesa më e madhe përbëhet nga zyrat e Posta Shqiptare prej 553. Një numër të madh zyrash postare rezulton të ketë ACS dhe United Transport prej 104, TNT me 29 zyra dhe DHL e Ylises, përkatësisht me 23 dhe 21 zyra. Pjesa tjetër e ofruesve të shërbimeve postare kanë vetëm nga një zyrë.

³ Raportimet e ofruesve për vitin 2012



Krahasuar me vitin 2003, numri i zyrave postare në të gjithë vendin gati është dyfishuar nga 580 zyra në 835 zyra. Numri i zyrave postare të ofruesve si DHL, TNT, Ylisess, ACS etj. është rritur me disa herë nga 45 zyra gjithsej në vitin 2003, në 286 zyra në fund të vitit 2012. Numri i zyrave të Posta Shqiptare është rritur nga 535 në vitin 2003, në 553 në fund të vitit 2012.

Në grafikun e mëposhtëm jepet situata e zyrave postare sipas ofruesve të shërbimeve postare.




Fig. 2: Numri i zyrave postare sipas ofruesve⁴

Në përgjithësi prezenca e zyrave postare, të ofruesve të tjerë, përveç Posta Shqiptare sh.a., është në qytetet kryesore të vendit.

Sektori postar në fund të vitit 2012, kishte 2622 punonjës, ku Posta Shqiptare është operatori më i madh bazuar mbi 90% të numrit total të punonjësve në këtë sektor.

Për sa i përket infrastrukturës dhe mjeteve postare Posta Shqiptare zotëron gati 80% të numrit total të automjeteve e pasuar nga AC me 8%, TNT me 5% DHL dhe RAD me 2% dhe pjesa tjetër e ofruesve së bashku zotërojnë vetëm 5% të numrit total të automjeteve.

I.4 Ofrimi i shërbimeve nga Posta Shqiptare sh.a.

Posta Shqiptare ka detyrimin për përmbushjen e shërbimeve bazë postare, ajo ka rrjetin e saj kombëtar me 553 zyra postare, të shtrirë në të gjithë territorin e vendit deri në zonat më të thella rurale, dhe ofron një numër të madh shërbimesh postare e financiare me cilësi e çmime konkurruese për individët, bizneset, institucionet, si dhe për ata që nuk kanë akses në sistemin bankar.

Shërbimet e ofruara nga Posta Shqiptare përfshijnë: shërbimet bazë postare, posta e letrave, e pakove, shërbimi i postës ekspres (EMS), shërbimet financiare, filatelinë, shitjet, si dhe shërbime të tjera të ofruara në çdo zyrë postare.

Diversifikimi dhe gati dyfishimi i numrit të shërbimeve të ofruara nga Posta Shqiptare, të mbështetura nga zhvillimi i infrastrukturës, përdorimi i teknologjive të reja kanë sjellë një rritje të cilësisë së shërbimeve postare dhe të performancës së përgjithshme të operatorit publik postar në këto vite dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për shërbimin postar.

Në grafikun e mëposhtëm jepet struktura e të ardhurave të Posta Shqiptare për vitin 2012.




Fig. 3: Struktura e të ardhurave të Posta Shqiptare për vitin 2012

⁴ Raportimi i ofruesve për vitin 2012

Ky zhvillim reflektohet dhe në rritjen e volumit të shërbimeve postare. Nga 5 milionë objekte postare në vitin 2005, në vitin 2012 numri i objekteve postare të pranuar, të përpunuara nga Posta Shqiptare ishte 23 milionë, ndërsa numri i objekteve postare për frymë të popullsisë në këtë periudhë është rritur me 4.5 herë.

Rritja e cilësisë së shërbimit postar reflektohet krahas plotësimit të standardit të shpërndarjes së objekteve postare dhe me uljen e ndjeshme të reklamacioneve dhe ankesave nga 1234 reklamacione për 5 milionë pranime në 538 reklamacione për 23 milionë pranime.

Sektori postar është rritur dhe në numrin e punonjësve nga 1669 punonjës në vitin 2005 në 2350 punonjës në vitin 2012.

Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit postar gjatë kësaj periudhe është realizuar në disa drejtime:

- rritja e numrit të automjeteve dhe mjeteve postare;
- modernizimi i qendrës transite;
- përmirësimi i sistemit të kontrollit dhe të sigurisë;
- plotësimi i standardeve në shpërndarjen e objekteve postare nga 2 ditë në qytete në vitin 2005, në 24 orë në vitin 2012;
- informatizimi i plotë i shërbimeve postare, i cili mundëson:
 - o regjistrimin e objekteve postare, në pranim, përpunim, transport, deri në dorëzimin përfundimtar;
 - o gjurmimin *on-line* të objekteve postare dhe informacionin në kohë reale për statusin e objektit, si dhe ndërfaqe elektronike me sistemin IPS.

Një zhvillim të ndjeshëm kanë pasur shërbimet financiare dhe bankare të ofruara nëpërmjet Postës Shqiptare. Aktualisht shërbimet financiare zënë mbi 45% të të ardhurave të gjithë kompanisë. Në zyrat postare kryhen mbi 20.5 milionë transaksione në vit me rreth 1 milion klientë në vit.

Në zhvillimin e këtyre shërbimeve ka luajtur një rol të madh informatizimi i shërbimeve financiare, duke realizuar shkëmbim informacioni në kohë reale të çdo transaksioni të kryer, duke sjellë rritje të performancës dhe cilësisë së shërbimit.

Përdorimi i TIK për zhvillimin e shërbimeve postare ka pasur një zhvillim të rëndësishëm në këto vite. Këto zhvillime janë kryer në përputhje me tendencat dhe strategjitë e zhvillimit të shërbimeve postare në rajon dhe në botë. Përdorimi i TIK ka ndihmuar në rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve nga ato tradicionale postare deri te transaksionet financiare, si dhe në shtrirjen e këtyre shërbimeve në tërë territorin e vendit, por dhe në integrimin e shërbimeve në rrjetin ndërkombëtar të shërbimeve postare. Përmes përdorimit të TIK është realizuar informatizimi tërësor i shërbimit postar, informatizimi tërësor i shërbimit financiar dhe bankar, si dhe ofrohen shërbimet *on-line*.

I.5 Sigurimi i shërbimit bazë postar nga Posta Shqiptare

Sigurimi i shërbimit bazë⁵ postar është detyrë e ngarkuar Posta Shqiptare sh.a. me ligjin nr. 8530/1999, të ndryshuar. Çmimet e shërbimit bazë duhet të jenë të barabarta dhe të përbalueshme për të gjithë. Kërkesat e veçanta për sigurimin e shërbimit bazë postar nga operatori publik postar janë përcaktuar në marrëveshjen e lidhur midis Posta Shqiptare sh.a. me Ministrin. Marrëveshja përcakton detyrimin për realizimin e shërbimit në jo më pak se 5 ditë në javë, detyrimi për pikat e aksesit duke kërkuar që në fund të vitit 2015, çdo zyrë postare e Posta Shqiptare t'i ofrojë shërbimin bazë postar një numri mesatar të popullsisë prej 6500 banorë në një sipërfaqe prej 56 km². Standardet për të arritur objektivat e cilësisë të vendosura në marrëveshje janë si më poshtë:

⁵ "Shërbimi bazë postar" kupton pranimin, përpunimin, vijimin dhe dorëzimin e objekteve të thjeshta të postës së letrave të adresuara, deri në 2 kg, të kolipostës së adresuar deri në 10 kg, shërbimin e urdhërpagesave postare dhe shërbimin e objekteve të regjistruara dhe të siguruar. Për kolipostën e adresuar ndërkombëtare që hyn në shtete të tjerë, kufiri i shërbimit bazë shtrihet deri në 20 kg.



Detyrimet e cilësisë së shërbimit universal për Posta Shqiptare					
Brenda për brenda qytetit		Ndërmjet qyteteve		Në fshatra	
D + 1	95%	D + 1	85%	D + 2	60%
D + 2	5%	D + 2	15%	D + 3	20%
				D + 4	20%

Përmbushja e detyrimeve të shërbimit bazë normalisht shoqërohet me kosto të lartë. Kostoja e realizimit të shërbimit universal dhe mënyra e realizimit të saj duhet të analizohet në mënyrë periodike për të shmangur ngarkesat e pandershme për operatorin publik postar. Për sigurimin e shërbimit bazë postar në ligjin nr. 8530/1999, si mekanizëm është parashikuar zona e rezervuar me shërbimet e rezervuara për t'u ofruar vetëm nga operatori publik postar.

Për përmbushjen e këtij detyrimi, Posta Shqiptare është, gjithashtu, përfituese e ndihmës shtetërore sipas vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 36, datë 1.2.2011 "Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore "Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a. të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera që janë në përputhje me aktivitetin e Posta Shqiptare sh.a. për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror"", si dhe në zbatim të vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 31.3.2011 "Për kryerjen nga Posta Shqiptare sh.a., të shërbimeve postare, financiare dhe shërbimeve të tjera që janë në përputhje me aktivitetin e kësaj poste, për institucionet e qeverisjes qendrore e vendore, institucionet e tjera publike, si dhe shoqëritë tregtare me kapital shtetëror".

Infrastruktura e shtrirë në të gjithë vendin me mbi 550 zyra postare, kapacitetet teknike, struktura organizative dhe numri i punonjësve i japin mundësinë/avantazhin Posta Shqiptare për realizimin e detyrimit të shërbimit universal.

I.6 Ofrimi i shërbimeve jo të rezervuara

Sikurse u prezantua më lart, përveç Posta Shqiptare sh.a. në tregun postar aktualisht ofrojnë shërbime jashtë zonës së rezervuar këta ofrues:

- DHL International (Albania) sh.p.k.;
- Postalink sh.p.k.;
- RAD MAIL sh.p.k.;
- T.N.T Express Albania sh.p.k.;
- Ulysses Enterprises sh.p.k.(Fedex);
- Albanian Courier sh.p.k.(A.C.);
- Albanian Courier Service sh.p.k. (A.C.S.);
- United Transport sh.p.k. (Uni Trans);
- Youth Albania Professional Services (YAPS) (Fondacion);
- Sky Net Albania sh.p.k.; dhe
- Agjencia e Abonimeve të Shtypit.

Gama e shërbimeve të ofruara prej tyre përfshin:

- Shërbimin special të dorëzimit të objekteve postare të postës së shpejtë, brenda vendit – Posta Ekspres;
- Shpërndarjen e objekteve të paadresuara për publicitet.
- Përgatitjen e objekteve postare.
- Shërbimin e përpunimit dhe transportit të objekteve postare të postës së jashtme.

Nga miratimi i dokumentit të parë të politikës në vitin 2003, nuk kemi rritje të ndjeshme në numrin e ofruesve të shërbimeve postare, megjithatë të dhënat e tregut tregojnë këta ofrues që ofrojnë shërbime jashtë zonës së rezervuar janë zhvilluar në këto vite duke zënë një pjesë tregu që shkon mbi 30%, bazuar në të ardhurat totale të deklaruara për vitin 2012.

Shërbimi ekspres përbën pjesën më të madhe në totalin e të ardhurave të realizuara për këta ofrues. Të ardhurat nga shërbimi ekspres zënë 29% të gjithë të ardhurave të tregut postar, ndërsa për Posta Shqiptare ky zë për vitin 2012 përbën 6.41% të të ardhurave. Të dhënat për strukturën e të ardhurave të tregut postar tregojnë një rritje të konkurrencës në këtë pjesë të liberalizuar të tregut postar.

I.7 Sfidat përpara sektorit postar

Gjatë viteve të fundit, tregu evropian i postës së adresuar është duke u përballur me sfida të shumta ku më kryesorja është rënia e volumit të punës. Sipas disa studimeve, norma vjetore e rritjes vazhdon të bjerë në tregun postar të BE-së, që shkojnë në një grup vendesh nga -2.5% në 0%, me rënie deri në -5%, në 40% të vendeve ka një rënie të normës vjetore më shumë se 5%. Sfidat e shfaqura në tregun rajonal dhe botëror postar lidhen me zhvillimet teknologjike dhe zëvendësimin elektronik.

Përputhja e kuadrit ligjor me *acquis communautaire* më të fundit, përmbushja e angazhimeve të marra në Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, janë hapa të nevojshëm për zhvillimin e mëtejshëm të tregut postar dhe integrimin e tij në tregun e përbashkët të BE-së.

Heqja e zonës së rezervuar, hapja e plotë e tregut, shtrojnë nevojën e përshtatjes së një kuadri rregullator që garanton zhvillimin e qëndrueshëm të tregut postar dhe ofrimin e shërbimit universal postar në cilësinë e kërkuar dhe me çmime të përballueshme për të gjithë.

Forcimi i kapaciteteve të nevojshme politikëbërëse dhe rregullatore për ndjekjen dhe zbatimin e duhur të politikës zhvillimit postar është i nevojshëm.

Zhvillimi i madh i tregut të komunikimeve elektronike dhe zëvendësimi elektronik shihet si një sfidë për sektorin postar në botë, por dhe te ne. Referuar të dhënave të tregut të komunikimeve elektronike, penetrimi i telefonisë së lëvizshme në vend është gati 190%, që tregon një shkallë të lartë përdorimi krahasuar dhe me mesataren e vendeve të BE-së.

Ndikimi i revolucionit të teknologjisë së informacionit në shoqërinë shqiptare është në zhvillim. Aksesit në internet është duke u rritur shpejt, avancimet teknologjike në shërbimet postare në botë kanë filluar të jenë prezent, gjithashtu, dhe në Shqipëri. Kjo e ka çuar sektorin postar drejt një opsioni që është reformimi përmes përdorimit të teknologjive të reja të avancuara dhe përshtatjes së modeleve bashkëkohore të biznesit. Ky proces duhet të vijojë për sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm të operatorit publik në kushtet e konkurrencës së plotë.

Ndjekja e zhvillimeve teknologjike kërkon një angazhim të vazhdueshme për sigurimin e shërbimeve cilësore dhe eficiente.

Tregtia elektronike, në veçanti, ofron mundësi të reja për zonat e largëta dhe me popullsi të rrallë për të marrë pjesë në jetën ekonomike, për të cilën ofrimi i shërbimeve të mira postare është një parakusht. Ofruesit e shërbimeve postare duhet të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga ky zhvillim.

Garantimi i shërbimit universal me hapjen e tregut duke shmangur ngarkesat e pandershme është, gjithashtu, një sfidë në kuadrin e zhvillimit të sektorit postar dhe mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të përdoruesve në të gjithë vendin pa dëmtuar konkurrencën.

II. Sektori postar në Bashkimin Evropian

II.1 Tendencat e zhvillimit të tregut postar në BE dhe në botë



Shërbimet postare përbëjnë një industri të rëndësishme në ekonominë e BE-së. Referuar një raporti të Komisionit për Këshillin dhe Parlamentin Europian⁶, në vitin 2004, shërbimet postare në BE fitonin rreth 90 miliardë euro ose afërsisht 1% të GDP-së në BE. Sektori i shërbimeve postare është, gjithashtu, një punëdhënës i rëndësishëm me rreth 1.6 milionë njerëz të punësuar direkt nga operacionet. Shërbimet postare janë konsideruar si një shërbim me interes ekonomik të përgjithshëm për BE-në.

Ofruesit e shërbimeve postare janë duke u përballur me konkurrencën e egër të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe nevojën e përshtatjes më mirë të biznesit të tyre në përgjigje të kërkesave të klientëve dhe përmirësimit të efikasitetit. Sektori postar është në zhvillim si në Bashkimin Europian dhe kudo në botë. Në vendet anëtare të BE-së është implementuar direktiva e tretë postare 2008/6/EC, e cila midis të tjerash, lidhet me hapjen e plotë të tregut postar. Ofruesit e shërbimeve postare janë duke u ballafaquar, gjithashtu, dhe me një rritje të konkurrencës si rezultat i hapjes së tregut. Disa ofrues të shërbimeve postare janë duke shkuar më tej dhe janë duke hyrë në tregje të afërta përmes zhvillimit të shërbimeve IT për klientët e tyre.

Volumet e postës së adresuar kanë vazhduar të rriten në tregun postar të BE-së⁷. Sipas disa të dhënave të fundit⁸, rritja e volumit në shërbimet postare rezulton më e theksuar në vendet e reja anëtare të BE-së se sa midis vendeve anëtare më të hershëm të BE-së. Tregu postar është duke vazhduar të zhvillohet drejt një tregu shpërndarjeje njëdrejtimësh ku posta e origjinuar nga biznesi llogaritet mesatarisht në 85% e volumit total postar.

Megjithatë konkurrenca në tregun e postës së letrave në BE është duke u zhvilluar ngadalë dhe pjesa e tregut të konkurrentëve mbetet e ulët. Pjesa e tregut të konkurrentëve shkon nga 8% deri në 14%, por në shumicën e vendeve anëtare të BE-së pjesa e tregut të konkurrentëve mbetet e ulët nën 2%. Kjo situatë është e ngjashme me atë në Shqipëri, për tregun e postës së letrave.

Në lidhje me sigurimin e shërbimit universal udhëzohet që rregullimi i Detyrimit të Shërbimit Universal (USO) të rishikohet, në mënyrë që të ai të mbetet i përballueshëm dhe të shmangen kostot e larta neto. Hapja e plotë e tregut ka hequr zonën e rezervuar si burimin tradicional të financimit për Detyrimit të Shërbimit Universal (USO). Aktualisht vetëm në pak vende të BE-së është parë e nevojshme kompensimi i ofruesit të shërbimit universal për kostot neto të USO-s. Vlerësimi i kostos neto të shërbimit universal kërkon një studim të detajuar të kostos dhe përfitimeve të elementeve të ndryshme të USO të saj.

Një tendencë tjetër në tregun e Bashkimit Europian është reduktimi i numrit të punonjësve postare. Zhvillimet teknologjike, zëvendësimi elektronik po shoqërohen me një rënie të ndjeshme në volumet postare. Gjithashtu, rritja e automatizimit është duke ndikuar ndjeshëm në fuqinë punëtore.

II.2 *Acquis communautaire* për shërbimin postar

Që nga viti 1994, vendet anëtare të BE-së kanë implementuar legjislacionin për liberalizimin e tregut postar. Burimi kryesor i *acquis communautaire* në fushën e aktivitetit postar është direktiva postare 97/67/EC, amendimet e miratuara me direktivën 2002/39/EC, gjithashtu, dhe vendimi i sjellë nga Gjykata Europiane dhe aktet e tjera që rregullojnë shërbimet e interesit të veçantë qeverisës (SGEI – Services of General Economic Interest) dhe konkurrenca e tregut të lirë.

Synimi parësor i *acquis communautaire* të BE-së në fushën e aktiviteteve postare është një kuadër rregullator për hapje në mënyrë graduale dhe të kontrolluar të tregut postar për konkurrencën e lirë të tregut, si dhe siguri i ofrimit të vazhduar të shërbimeve postare universale.

⁶ Report from the Commission to the Council and the European Parliament on the application of Postal Directive 97/67/EC as amended by directive 2002/39/EC

⁷ Report from the Commission to the Council and the European Parliament on the application of Postal Directive 97/67/EC as amended by directive 2002/39/EC

⁸ Konferenca Rajonale, Shkup 2012

Në shkurt 2008, Këshilli dhe Parlamenti European miratuan direktivën 2008/6/EC; synimi i kësaj direktive ishte liberalizimi i plotë i tregut të shërbimeve postare. Ka dy objektiva kryesorë në shtetet anëtare të BE-së që janë të ndërlidhura:

- E para eliminimi i të gjitha zonave të rezervuara postare deri në vitin 2013.
- E dyta promovimi i shërbimeve universale përmes forcave të tregut të plotësuara nga masa të tjera kur është e nevojshme. Deri më sot, shumica e vendeve kanë eliminuar zonat e rezervuara. Të gjitha vendet e BE-së planifikojnë të veprojnë kështu në vitin 2013.

Direktiva e tretë postare përcaktoi për shumicën e vendeve anëtare që në termat e volumit postar përbënin gati 95% të tregut postar të BE-së, si afat për hapjen e plotë të tregut nga data 31 dhjetor 2010 dhe si afat të dytë për hapje të plotë të tregut për pjesën e mbetur të shteteve anëtare nga data 31 dhjetor 2012. Aktualisht tregjet më të mëdha postare në BE, janë plotësisht të hapur. Në janar 2011, ishte liberalizuar 95% e tregut të brendshëm postar.

Objektivi kryesor i direktivës së tretë postare është zhvillimi i një tregu të brendshëm postar konkurrues që ofron shërbime me cilësi të lartë. Neni 9 i direktivës së tretë postare thotë që:

- Për shërbimet që bien jashtë fushës së shërbimit universal, shtetet anëtare mund të prezantojnë autorizimet e përgjithshme për aq sa është e nevojshme për të garantuar përputhjen me kërkesat esenciale.

- Për shërbimet që bien brenda shërbimit universal, shtetet anëtare mund të prezantojnë procedurat e autorizimit, duke përfshirë licencën individuale, për aq sa është e nevojshme me qëllim garantimin e përputhjes me kërkesat esenciale dhe për të siguruar ofrimin e shërbimit universal¹.

Referuar Raportit të BE-së⁹, duket se ka pasur një ngadalësim në hapjen e mëtejshme të tregut postar në BE në disa shtete anëtare e lidhur kjo me kushtet e punës të konkurrentëve kryesorë, mungesa e një fushe loje të barabartë për ofruesit e shërbimeve postare, kushtet për pagën minimale etj.

II.3 Sigurimi i Shërbimit Universal (USO) në BE

Direktiva e tretë postare parashikon hapjen e tregut postar në shumicën e vendeve anëtare të BE-së nga fundi i vitit 2012. Masat kryesore të direktivës së tretë postare krahasuar me direktivën e mëparshme lidhur me shërbimin universal përfshijnë:

- rishikimin e përkufizimit të shërbimit universal (posta direkte mund të konsiderohet si objekt i korrespondencës);
- mundësinë që të caktohen ofrues shërbimi universal të ndryshëm, për elemente të ndryshme të shërbimit universal dhe/ose pjesë të ndryshme të territorit të vendit;
- procedura për sigurimin e shërbimit universal përmes garës, kontraktimit ose negociimit;
- direktiva konfirmon që në thelb ofrimi i shërbimit universal që përmbush standardet e cilësisë të përcaktuara pa nevojën e zonës së rezervuar ose të drejtave speciale;
- shërbimi universal postar mund të lejohet të diversifikohet më tej me qëllim përballimin e konkurrencës, t'i përgjigjet kërkesave të reja të klientëve dhe të sigurojë burime të reja financimi.

Një nga çështjet reale në shtetet anëtare të BE-së kanë të bëjnë me: A është i nevojshëm financimi i detyrimit të shërbimit universal dhe nëse po si? Në përputhje me direktivën europiane, shtetet anëtare kanë dy mënyra për të siguruar financimin e kostos neto të detyrimeve të shërbimit universal nëse është e nevojshme:

- Fondet publike;
- Ndarja e kostove neto të detyrimeve të shërbimit universal ndërmjet ofruesve të shërbimit postar ose përdoruesve.

⁹ Report from the Commission to the Council and the European Parliament on the application of Postal Directive 97/67/EC as amended by directive 2002/39/EC



Megjithatë vlerësohet se përkufizimi i dhënë në direktivën e tretë për detyrimin e shërbimit universal mbetet i gjerë dhe është interpretuar në mënyra të ndryshme nga shtetet anëtare. Edhe pse përkufizimi i shërbimit universal nuk ndryshon në mënyrë drastike nga një shtet në tjetrin, fusha e shërbimit universal është e ndryshme midis vendeve të BE-së. Holanda, Suedia janë shembuj të mirë të shteteve anëtare, të cilat kanë hapur tregjet e tyre dhe kufizuar detyrimin e shërbimit universal të shërbimit bazë.

III. Vizioni dhe objektivat

Ky dokument politikash përcakton këtë vizion për zhvillimin e sektorit postar në periudhën afatmesme, afatgjatë:

Vizioni

Përmirësimi i vijueshëm dhe sigurimi i shërbimeve postare cilësore me përfitime maksimale për çdo kategori përdoruesish përmes zhvillimit të një tregu postar të hapur e konkurrues, i gatshëm për t'u bërë pjesë e tregut të përbashkët të Bashkimit Europian.

Arritja e këtij vizioni do të bëhet përmes hartimit dhe zbatimit të programeve për krijimin e një mjedisi të përgjithshëm ligjor dhe institucional që i garanton konsumatorëve ofrimin e shërbimeve cilësore, interesat ekonomikë të tyre në një treg konkurrues dhe efektiv. Objektivi i qeverisë nëpërmjet politikës postare është zhvillimi i sektorit postar kombëtar dhe reflektimi në mënyrë adekuate i zhvillimeve teknologjike dhe zhvillimeve globale, duke marrë në konsideratë rrethanat e tregut shqiptar, si dhe harmonizimi i sistemit postar në Shqipëri me BE-në. Në linjë me kërkesat e direktivës postare do punohet për:

- sigurimin i një shërbimi postar universal me cilësi të lartë me çmim të përballueshëm dhe eficient;
 - një zhvillim të qëndrueshëm dhe rregullimi adekuat të tregut të hapur postar;
 - një mbrojtje më të mirë të përdoruesve të shërbimeve postare;

 - promovimin e kushteve të ndershme të tregut me konkurrencë efektive të realizuar përmes rregullimit specifik të sektorit;
 - rregullimin me anë të autoritetit të pavarur rregullator për sektorin postar;
- Në veçanti objektivat kryesore të politikës për periudhën 2013-2017 janë:
- Liberalizimi i plotë i tregut postar me dy hapa:
 - Reduktimi i zonës së rezervuar 100 g në 50 g brenda vitit 2013;
 - Hapja e plotë e tregut postar dhe heqja e zonës së rezervuar në fund të vitit 2014.
 - Rishikimi i kuadrit ligjor në përputhje të plotë me *acquis communautaire*:
 - Ligji nr. 8530/1999, i ndryshuar është pjesërisht në përputhje me direktivat e fundit postare. Në veçanti ligji nr. 8530/1999 nuk ka transpozuar direktivën e tretë postare 2008/6/EC.
 - Detyrat e autoritetit rregullator dhe të politikëbërësit kanë nevojë të rishikohen dhe plotësohen me rishikimin e kuadrit ligjor.
 - Garantimi i ofrimit të shërbimit universal. Skema e sigurimit të shërbimit universal duhet të rishikohet në përputhje me ecurinë e liberalizimit të tregut postar dhe ndryshimet e pritshme ligjore sipas *acquis communautaire*. Përkufizimi i shërbimit universal postar ka nevojë të rishikohet dhe saktësohet, përfshirë mënyrat e realizimit të këtij shërbimi në përputhje me *acquis communautaire* dhe rrethanat e zhvillimit në vend.
 - Përmirësimi i vijueshëm i cilësisë së shërbimeve postare në përputhje me standardet ndërkombëtare për shpërndarjen e objekteve postare. Do të punohet për garantimin e standardeve europiane e botërore të cilësisë në shërbime. Zhvillimi dhe implementimi i sistemit të adresave do të sigurojë një përmirësim në cilësinë e shërbimeve postare dhe zgjerim në përdorimin e kodit postar.

- Forcimi i kapaciteteve institucionale të rregullatorit dhe politikëbërësit. Krijimi i strukturës përkatëse për rregullimin postar në AKEP dhe fuqizimi i strukturës së ministrit për sektorin postar.
- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit postar, promovimi i produkteve dhe shërbimeve të reja. Modernizimi dhe diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve të reja, stimulimi i rritjes së tregut nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja për operatorin publik postar dhe tregun në tërësi. Zgjerimi i tregut të shërbimeve nëpërmjet implementimit të shërbimeve të reja postare e financiare për plotësimin e nevojave të konsumatorëve dhe mbushjes së kapaciteteve të lira.
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare. Në fund të periudhës të gjithë ofruesit e shërbimeve postare të kenë akses në elementet e infrastrukturës postare në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë sistemin e kodit postar, sistemin e adresave, informacionin mbi ndryshimin e adresave, kutitë postare dhe ato të shpërndarjes postare.
- Zhvillimi i burimeve njerëzore. Zhvillimi i sektorit postar kërkon zhvillimin e burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të stafit në aplikimin e teknologjive të reja, për të zotëruar risitë në zonat kyçe të veprimtarive postare. Forcimi i kapaciteteve të sektorit postar për t'iu përgjigjur nevojave për ndryshime në treg dhe përmirësimi i kualiteteve të burimeve njerëzore në sektorin postar do të jetë në vëmendje të vijueshme.

Në planin e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar objektivat e këtij dokumenti janë në përputhje me objektivat e Strategjisë Globale Postare të miratuar nga UPU në kongresin e zhvilluar në Doha në vitin 2012. Në mënyrë të veçantë këto objektiva përfshijnë:

- Objektivi 1: Përmirësimi i ndërveprimit të rrjeteve ndërkombëtare postare;
- Objektivi 2: Sigurimi i njohurive teknike dhe ekspertizës në lidhje me sektorin postar;
- Objektivi 3: Promovimi i produkteve dhe shërbimeve të reja (zhvillimi i rrjetit 3D);
- Objektivi 4: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit postar.

IV. Programet që do të ndiqen

Kuadri i politikës sektoriale për zhvillimin e shërbimeve postare për periudhën 2013-2017, do synojë hapjen e plotë të tregut, krijimin e një kuadri ligjor në përputhje të plotë me *acquis communautaire*, si dhe krijimin e një regjimi rregullator eficient duke lehtësuar barrierat e hyrjes në treg dhe sigurimin e mjedisit për operimin në kushte të barabarta dhe të ndershme për të gjithë ofruesit në treg me qëllim sigurimin e shërbimeve cilësore dhe eficiente për konsumatorët në të gjithë vendin. Programet, aktivitetet në zbatim të këtij dokumenti do të synojnë vazhdimin e ofrimit të shërbimit universal për të gjithë.

IV.1 Liberalizimi i plotë i tregut

Liberalizimi i tregut të shërbimeve postare do të bëhet në përputhje me direktivat postare. Aktualisht në vendet e Bashkimit Europian 95% e tregut postar është liberalizuar plotësisht në vitin 2010 dhe pjesa tjetër e këtij tregu kishte detyrimin për liberalizim brenda vitit 2012.

Objektivi kryesor i direktivës së tretë postare është zhvillimi i një tregu të brendshëm postar konkurrues që ofron shërbime me cilësi të lartë. Me qëllim sigurimin e një tregu të lirë dhe të ndershëm postar në Shqipëri, është esenciale që të gjithë ofruesit e shërbimeve të interesuar mund të hyjnë në treg. Për realizimin e hapjes së plotë të tregut postar, reduktimi i zonës së rezervuar 100 g në 50 g brenda vitit 2013 dhe hapja e plotë e tregut postar që nënkupton heqjen e zonës së rezervuar në fund të vitit 2014.

Hapja graduale dhe progresive e tregut postar në Shqipëri drejt konkurrencës i ka siguruar Postës Shqiptare kohë të mjaftueshme për të kryer modernizimet dhe ristrukturimet e nevojshme të kërkuara për të siguruar një qëndrueshmëri afatgjatë në kushtet e reja të tregut.

Hapja e plotë e tregut postar në Shqipëri do të ndihmojë rritjen e madhësisë të këtij tregu dhe do të kontribuojë me tej në mbajtjen e punësimit të qëndrueshëm dhe me cilësi brenda Postës



Shqiptare, si dhe të lehtësojë krijimin e vendeve të reja të punës në ofruesit e tjerë në vend. Rritja e mëtejshme e konkurrencës në tregun postar shqiptar do të aftësojë më shumë sektorin postar për t'u integruar me metodat alternative të komunikimit dhe lejojë përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

IV.2 Zona e rezervuar

Zona e rezervuar është përdorur si një mekanizëm për kompensimin e kostove për sigurimin e shërbimit universal postar. Studimet e kryera nga Komisioni European tregojnë që zona e rezervuar nuk është më zgjidhja e preferuar për financimin e shërbimit universal. Direktiva e tretë postare kërkon heqjen e zonës së rezervuar dhe jep disa mënyra të financimit të shërbimit universal postar.

Në linjë me *acquis communautaire* ky dokument përcakton si objektiv afatmesëm liberalizimin e plotë të tregut postar me dy hapa. Synimi bazë është sigurimi i ofrimit të qëndrueshëm të një shërbimi universal që, gjithashtu, përputhet me standardet e cilësisë të përcaktuara nga shtetet anëtare të BE-së në përputhje me direktivën 97/67/EC. Zhvillimet e deritanishme tregojnë se kjo mund të sigurohet në Shqipëri pa nevojën e një zone të rezervuar.

Me hapjen e plotë të tregut, zona e rezervuar nuk duhet të jetë zgjidhja e preferuar për financimin e shërbimit universal në Shqipëri. Megjithatë një analizë e hollësishme për efektet e hapjes së tregut dhe mënyra e garantimit të ofrimit të shërbimit universal do ndërmerret me miratimin e këtij dokumenti në bashkëpunim me rregullatorin dhe operatorin publik postar.

Zhvillimet dhe progresi i bërë në këto vite, tregojnë që Posta Shqiptare është e aftë për të dhënë rritje dhe punësim, si dhe për të siguruar disponueshmërinë e një shërbimi eficient të interesit të përgjithshëm ekonomik për të gjithë përdoruesit.

Posta Shqiptare do të jetë e aftë për konkurrencën, të përballet me kërkesat e reja të konsumatorit dhe sigurojë burime të reja të financimit duke vazhduar diversifikimin e aktiviteteve të saj duke ofruar shërbime të tjera që shoqëria shqiptare ka nevojë.

Në përputhje me të dhënat e BE-së (Ref. 1), reduktimi i zonës së rezervuar nga 100 gramë në 50 gramë, llogaritet për hapjen e një shtese prej 7% në tregun e postës direkte. Vlerësohet se ky reduktim nuk ka një impakt të madh në zhvillimin e konkurrencës, sepse hap vetëm një pjesë të vogël të tregut postar në termat e volumit. Për këtë arsye mendohet që duhet të kalohet në reduktimin e zonës së rezervuar brenda vitit 2013 dhe në heqjen e zonës së rezervuar në fund të vitit 2014.

IV.3 Përmirësimi i kuadrit ligjor

Kuadri aktual ligjor për sektorin postar është në përputhje me direktivën 97/67/EC dhe direktivën 2002/39/EC, por nuk ka të transpozuar direktivën e tretë postare 2008/6/EC. Hartimi i një ligji të ri "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë" në harmoni të plotë me direktivat postare është një nga programet që do të ndërmerren menjëherë me miratimin e këtij dokumenti politikash me qëllim përmbushjen e angazhimeve të MSA-së.

Ligji i ri do të rishikojë dhe plotësojë përcaktimet në lidhje me rregullimin e përgjithshëm për shërbimet postare, qartësimin e kompetencave të politikë bërësit dhe rregullatorit, detyrime të qarta për të gjithë ofruesit e shërbimeve postare, mekanizmat për garantimin e shërbimit universal, përcaktimin e parimeve për tarifimin e shërbimeve bazuar në kosto, trajtimin e zonës së rezervuar sipas hapave të liberalizimit të tregut, kriteret për standardet e cilësisë së shërbimit, detyrimet për transparencë të llogarive për ofruesin/ofruesit e shërbimit universal, mbrojtjen e përdoruesve të shërbimeve postare etj.

Përmirësimi i kuadrit ligjor do të synojë realizimin e një liberalizimi të plotë të suksesshëm përmes sigurimit të aksesit të barabartë dhe të ndershëm të ofruesve në treg dhe hyrësve të rinj në treg, mekanizmave rregullatorë eficientë, si dhe harmonizim me politikën e Bashkimit European dhe strategjitë globale të zhvillimit të sektorit postar të miratuara nga UPU.

Për një treg të liberalizuar, kushti i parë është heqja e pengesave të hyrjes në treg. Kjo përfshin si kërkesat ligjore, kushtet e licencimit dhe pengesat joligjore (aksesi në kutitë postare). Me

qëllim sigurimin e një tregu të lirë dhe të ndershëm postar në Shqipëri, është esenciale që të gjithë ofruesit e shërbimeve të interesuar të mund të hyjnë në treg. Me liberalizimin total është i nevojshëm një legjislacioni i ri për licencimin, i cili do të transpozojë direktivën e tretë postare me legjislacionin kombëtar.

IV.4 Krijimi i një kuadri rregullator efektiv dhe roli i AKEP-it

Me hapjen e tregut dhe ndarjen e detyrave të politikëbërësit nga ato rregullatore, AKEP-i luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e tregut postar në Shqipëri në garantimin e një konkurrence të ndershme në treg. Sfidë kryesore para AKEP-it është të rregullojë ndëroperimin në një treg me shumë operatorë/ofrues, marrja e veprimeve kundër barrierave strategjike të hyrjes dhe sigurimi që tarifat të jenë përshtatur më shumë me kostot.

AKEP-i është autoriteti përgjegjës për monitorimin e rregullt dhe raportimin për tregun postar shqiptar. Kjo është një nga detyrat e rëndësishme me qëllim identifikimin e ndonjë mangësie dhe problemi në kohë për të qenë i aftë të ndërmarrë veprimet (ligjore), kur janë të nevojshme dhe implementimin e masave korrigjuese.

Kostoja neto e shërbimit universal duhet të llogaritet, nën mbikëqyrjen e AKEP-it, si diferencë ndërmjet kostonetë të ofruesit të shërbimit universal të caktuar që operon nën detyrimin e shërbimit universal dhe që nuk operon nën detyrimin e shërbimit universal.

Sikurse është prezantuar më lart, krijimi i strukturës rregullatore postare është e nevojshme pas ndarjes së detyrave të politikëbërësit nga ato rregullatore në vitin 2009. Po kështu është e rëndësishme fuqizimi i rregullatorit postar duke pasur parasysh që tregu postar është në thelb i ndryshëm nga tregjet e tjera. Për t'iu përgjigjur nivelit të kompleksitetit të këtij tregu është e rëndësishme të ketë një strukturë të veçantë për rregullimin postar. Qeveria do të mbështesë miratimin nga Kuvendi të strukturës së propozuar të AKEP-it brenda vitit 2013.

Me qëllim krijimin e një kuadri rregullator efektiv më poshtë jepen disa rekomandime:

- AKEP-i duhet të zhvillojë metodologjitë për mbajtjen e llogarive të duhura dhe të sakta, për shërbimet postare në Shqipëri, në veçanti për shërbimin universal të ofruar nga Posta Shqiptare;
- AKEP-i duhet periodikisht të vlerësojë dhe të përshtatë praktikatat më të mira rregullatore postare të zhvilluara nga vendet e tjera të industrializuara;
- AKEP-i së bashku me strukturën politikëbërëse duhet të bashkëpunojnë për zhvillimin e analizave dhe procedurave që do t'i lejojnë ata të sigurojnë shërbimin universal nga mbështetja mbi forcat e tregut kur është e mundur dhe e përshtatshme dhe të përdorë procedurat e përcaktuara të prokurimit publik ku është e nevojshme për të plotësuar forcat e tregut. Kjo duhet të bëhet në një mënyrë transparente, jodiskriminuese, të ndershme dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe me sa më pak shtrembërim të tregut;
- Ministri dhe AKEP-i duhet të zhvillojë analiza dhe procedurave të nevojshme për të siguruar që fusha e USO është në linjë me ndryshimet e nevojshme për përdoruesit dhe zhvillimin e mjedisit teknik, ekonomik e social në Shqipëri.
- AKEP-i duhet të sigurojë që kuadri rregullator nuk krijon pengesa për hyrjen që janë në kundërshtim me kërkesat e objektivat e direktivës së tretë postare.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e drejtimeve kryesore, të masave dhe aktiviteteve që do të ndërmerren për realizimin e një liberalizimi të suksesshëm të tregut postar në Shqipëri:



Kushtet kryesore	Masat	Hapat e implementimit në Shqipëri
Jo barriera hyrese/akses i hapur për tregun	Jo barriera ligjore. Kërkesat e duhura për licencimin Jo barriera joligjore Hapja e aksesit në infrastrukturën ekzistuese postare	Rregulla të reja për licencimin për reflektimin e heqjes së “zonës së rezervuar” Legjislacioni i ri Rregulla të reja për të siguruar hapjen e aksesimit
Zhvillimi i një fushe loje të ndershme/të barabartë	Të njëjtat rregulla për çdo ofrues në treg për të siguruar trajtimin e barabartë të tyre Josubvencionim të tërthortë abuziv për të kompensuar shërbimin universal me procedura monopoli Rregullat e punës/paga minimale etj. Regjimi i TVSH-së	Analizë e subvencionit për financimin e Posta Shqiptare Sigurimi që të gjithë ofruesit janë subjekt i rregullave të njëjta për financimin
Rregullator kombëtar i pavarur dhe i fortë	Kontrolli i çmimeve të vendosura nga operatori publik postar me qëllim garantimin që ato bazohen në kostot reale Shqyrtim i llogaritjeve të USO për të siguruar shmangien e abuzimit me subvencionimin e USO-s Të qenit i pavarur dhe sigurimi i pushtetit dhe kompetencave të nevojshme për të vepruar në mënyrë autonome	Rregullim i ashpër nga AKEP-i në vendosjen e çmimeve nga Posta Shqiptare AKEP-i të analizojë iniciativat e reja të Postës Shqiptare (post bank, ofrimin e internetit etj.) me qëllim sigurimin që nuk subvencionohet AKEP-i të veprojë shpejt dhe fuqishëm kur ngrihen probleme të konkurrencës në sektorin postar Të mos lejojë abuzimin me ndihmën shtetërore
Komunikimi proaktiv me Komisionin Europian	Të sigurohet që rregullat e konkurrencës janë implementuar si duhet	Parashqyrtimi i propozimeve ligjore dhe pajtueshmëria me direktivën postare

IV.5 Garantimi i ofrimit të shërbimit bazë/universal postar

Ndër objektivat e rëndësishëm të politikës është sigurimi i shërbimit bazë apo universal postar dhe me hapjen e plotë të tregut. Hapja e tregut dhe rishikimi i kuadrit ligjor në linjë me *acquis communautaire* në nevojën e rishikimit të kuadrit të përgjithshëm të realizimit të shërbimit universal apo shërbimit bazë postar duke e përshtatur me rrethanat e vendit.

Kuadri ligjor në fuqi, përcakton operatorin publik si ofruesin e shërbimit bazë postar, si dhe përcakton mënyrën e kompensimit për sigurimin e shërbimit bazë postar nëpërmjet shërbimeve të rezervuara. Heqja e zonës së rezervuar me liberalizimin e tregut duhet të shoqërohet përcaktimin e një kuadri të qartë për shërbimin universal postar.

Direktiva 2008/6/EC përcakton se: “Shërbimi universal garanton, në parim, pranimin dhe shpërndarjen në shtëpi ose në godinën e çdo personi fizik ose juridik për çdo ditë pune, edhe në zonat e largëta dhe me popullsi të rrallë”. Neni 3 i direktivës postare të BE-së, kërkon sigurimin e të drejtës së shërbimeve universale për të gjithë përdoruesit në gjithë territorin e tyre me çmime të përballueshme, dhe që ata duhet të sigurojnë të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që të sigurojnë densitetin/shpërndarjen e kënaqshme të zyrave postare dhe pikave të tjera të aksesit në përputhje me nevojat e përdoruesve. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të sigurojnë kryerjen e shërbimit universal të paktën në pesë ditë të javës. Vetëm autoriteti rregullator kombëtar mund të vendosë dhënien e përjashtimeve nga këto detyrime.

Direktiva jep mundësinë e përfshirjes në ofrimin e shërbimit universal postar të ofruesve të ndryshëm postarë, si dhe përcakton heqjen e zonës së rezervuar si mekanizëm financiar për kompensimin e kostove të shërbimit universal, duke orientuar drejt krijimit të fondeve publike ose ndarjen e kostove midis ofruesve.

Sikurse është analizuar përkufizimi i shërbimit bazë postar është i gjerë dhe me avancimet teknologjike dhe e-zëvendësimin ky përkufizim është duke u rishqyrtuar. Në një studim të kryer nga Banka Botërore (Ref 3) arrihet në konkluzionin që shpërndarja e letrës (krahasuar me shërbimet e tjera që mund të ofrohen nga zyrat postare) nuk është një kërkesë universale në vendet në zhvillim, kështu që madhësia e tregut në vendet në zhvillim është që USO-t nuk mund të përmbushen/arrihen në modelin e monopolit, dhe që operatorët monopol kanë kosto të larta për zhvillimin e sektorit dhe mirëqenien e konsumatorit.

Vërehet se konsumatori mesatar në Shqipëri, dërgon vetëm pak letra në vit dhe ndoshta një numër njerëzish në zonat rurale shqiptare nuk dërgojnë dhe as marrin as një letër të vetme (të paktën përmes rrjetit të kapur/mbuluar nga Posta Shqiptare). Në veçanti ka një kërkesë të ulët nga biznesi për të shpërndarë postën në zonat rurale në Shqipëri. Ka dy arsye për këtë: mungesa e shërbimeve që kërkojnë faturimin, dhe vështirësia për një objektiv tërheqës për kompanitë në termat e qëllimeve të marketingut.

Përtej kësaj, aktualisht Posta Shqiptare ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe kryen shpërndarjen e shumë shërbimeve të tjera dhe jo thjesht postën e letrave. Shërbimet financiare përfaqësojnë rreth 45% të totalit të të ardhurave postare, dhe zyrat postare janë një pikë aksesi parësore për shërbimet financiare për shumicën e popullsisë shqiptare. Është e nevojshme që përkufizimi ligjor për shërbimin universal postar të rishikohet dhe përshtatet me rrethanat e vendit dhe nevojat e përdoruesve.

IV.6 Financimi i shërbimit universal

Referuar direktivës europiane, shtetet anëtare kanë dy mënyra për të siguruar financimin e kostos neto të detyrimeve të shërbimit universal nëse është e nevojshme.

- Fondet publike
- Ndarja e kostove neto të detyrimeve të shërbimit universal ndërmjet ofruesve të shërbimit postar ose përdoruesve.

Zbatimi i direktivës europiane, për mënyrat e sigurimit të shërbimit bazë postar, si dhe të financimit të kostos neto të detyrimeve të shërbimit universal kërkon ndryshime të ligjit për shërbimin postar, pasi aktualisht ligji përcakton operatorin publik si ofruesin e shërbimit bazë dhe zonën e rezervuar si mekanizëm kompensimi për kostot e shërbimit universal. Rishikimi i kuadrit të përgjithshëm ligjor për shërbimin universal do të konsiderojë:

1. Formulimin e qartë të përkufizimit të detyrimit të shërbimit universal në Shqipëri dhe fusha e zbatimit të tij;
2. Sigurimin që llogaritë janë qartësisht të ndara dhe të mirë shpërndara midis kostove të shërbimit universal dhe kostove të tjera si caktimi në mënyrë të drejtë të kostove të përbashkëta për shërbimet e tjera (Post Bank, Internet etj.);
3. Krijimin e hapësirave për ofrimin e shërbimit universal nga një ose disa ofrues;
4. Përcaktimin nga AKEP-i të një metode llogaritje të qartë dhe transparente për vlerësimin nëse detyrimi për shërbimin universal shkakton ndonjë kosto ose jo.

Kuadri rregullator i BE-së¹⁰, skicon qartë se ndihma shtetërore, e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën është e ndaluar. Në përputhje me direktivat e BE-së mbi legjislacionin postar, shtetet anëtare mbeten të lira të vendosin se si të organizojnë dhe financojnë detyrimet e shërbimit universal. Ata duhet të sigurojnë që metoda e zgjedhur prej tyre është e përputhur me rregullat e BE-së për ndihmën shtetërore duke garantuar përmbushjen e detyrimit për shërbimin universal pa dëmtuar konkurrencën e ndershme në treg.

IV.7 Ndarja e llogarive dhe kosto neto e shërbimit universal

Direktiva e tretë postare heq zonën e rezervuar dhe thekson që ndonjë ndihmë e marrë nga shteti ose ndonjë fond kompensimi për të mbuluar kostot neto të shërbimit universal nuk duhet të

¹⁰ Shih neni 107 të TFEU



përdoret për subvencionimin e aktiviteteve jashtë USO, sepse kjo mund të shtrembërojë konkurrencën.

Çmimi i shërbimeve konkurruese, i ofruar nga USO duhet në parim të jetë të paktën i barabartë me koston totale mesatare të ofrimit për shkak të vështirësive të shpërndarjes së kostove të përbashkëta. Është detyrë e AKEP-it të kontrollojë çmimet dhe llogarisë kostot neto të USO me qëllim shmangien e ndonjë subvencionimi të tërthortë.

Për të garantuar që kosto e shërbimit universal nuk përbën barrë të pandershme si për ofruesin e shërbimit universal ashtu dhe për dëmtimin e konkurrencës në treg, është e nevojshme llogaritje e koston të shërbimit universal.

Referuar aneksit 1 të direktivës së tretë postare, kosto neto e USO është: “çdo kosto e lidhur dhe e nevojshme për operimin e ofrimit të shërbimit universal. Kosto neto e detyrimeve të shërbimit universal llogaritet, një diferencë midis koston neto të një ofruesi të caktuar të shërbimit universal që operon me detyrimet e shërbimit universal dhe të njëjtit ofrues shërbimi postar që operon pa detyrimet e shërbimit universal”.

Posta Shqiptare, ose ndonjë ofrues tjetër i shërbimit universal, duhet të mbajnë llogari të ndara brenda sistemeve të tyre kontabël me qëllim një dallim të qartë ndërmjet secilit prej shërbimeve dhe produkteve, të cilat janë pjesë e shërbimit universal dhe atyre të cilat nuk janë. Kjo ndarje e llogarive duhet të përdoret si të dhëna kur llogaritet kosto neto e shërbimit universal. Ky sistem do të operojë mbi bazë aplikimi konsistent dhe parimet e llogaritjes së koston të justifikuar objektivisht. Sistemi i llogarive i përdorur për llogaritjen e kostove, i cili duhet të miratohet nga rregullatori, mban parasysh:

- Kostot të cilat mund të caktohen direkt për një shërbim të caktuar ose produkt do të caktohen direkt;
- Kostot e përbashkëta, të cilat nuk mund të caktohen direkt në një shërbim ose produkt të veçantë do të caktohen si më poshtë:
- Nëse është e mundur, kostot e përbashkëta duhet të shpërndahen mbi bazën e analizës direkte të origjinës së vetë kostove.
- Kostot e përbashkëta, të cilat janë të nevojshme për ofrimin dhe të shërbimeve universale dhe shërbimeve jouniversale, do të shpërndahen siç duhet. Të njëjtat elemente/nxites së koston duhet të aplikohen si për shërbimet universale dhe për shërbimet jouniversale.
- Llogaritjet do të marrin në konsideratë të gjitha elementet e tjera përkatëse, duke përfshirë përfitimet e tregut dhe ato jomateriale që grumbullohen në një ofrues të shërbimit postar i caktuar për ofrimin e shërbimit universal, të drejtën për një fitim të arsyeshëm dhe stimujt për një kosto eficiente.

Të gjithë operatorët/ofruesit duhet të jenë subjekt i parimeve të ndershme të financimit në tregun postar. Subvencioni i tërthortë dhe mundësia e abuzimit me kompensimin e shërbimit universal nga të ardhurat monopol për aq kohë sa ekzistojnë situatat monopol duhet të jenë në vëmendje të rregullatorëve si AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës. Subvencioni i tërthortë në sektorin postar nënkupton “që një sipërmarrës mbart ose shpërndan të gjitha ose pjesërisht kostot e aktivitetit të tij të një produkti ose tregu gjeografik në aktivitetin e një produkti tjetër ose tregu tjetër gjeografik”¹¹.

IV.8 Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit postar, promovimi i produkteve dhe shërbimeve të reja

Për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit postar do të nxitet modernizimi dhe diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve të reja nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja. Do të punohet për zgjerimin e tregut të shërbimeve nëpërmjet implementimit të shërbimeve të reja postare e financiare

¹¹ Njoftim nga Komisioni mbi aplikimin e rregullave të konkurrencës në sektorin postar dhe një vlerësim i disa masave shtetërore në lidhje me shërbimet postare. (Gazeta Zyrtare C 39, 6.2.1998, p. 2-18)

duke plotësuar nevojat e konsumatoreve. Zhvillimet ligjore e rregullatore duhet të nxisin bashkëpunimin ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare për të përfituar nga infrastruktura postare ekzistuese në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë iniciativa për zgjerimin e sistemit të kutive postare, përdorimin e kodit postar, sistemin e adresave etj.

Rishikimi i kuadrit ligjor e rregullator do të përcaktojë detyrime të qarta për të gjithë ofruesit e shërbimeve për garantimin e shërbimeve me cilësi të lartë dhe një mbrojtje më të mirë të përdoruesve të këtyre shërbimeve.

Për operatorin publik postar, qeveria do të mbështesë të gjitha iniciativat për:

- rritjen e cilësisë së shërbimeve postare sipas standardeve bashkëkohore, në përputhje me kërkesat e PostEuropës për çdo proces operacional, evidentimi i normativave D+1, D+2, D+3 dhe kartelave të treguesve cilësorë për çdo operacion;
- krijimin e hartës rajonale;
- pjesëmarrjen në testimin e zbatimit të standardeve të cilësisë në tri nivele:
 - o ndërkombëtar, kombëtar dhe rajonal;
- zhvillimin e bashkëpunimeve në fushën e shërbimeve postare me vendet fqinje, si dhe me të gjitha vendet e tjera të botës, anëtare të UPU-së dhe Postë Europës për integrimin drejt standardeve të cilësisë;
- shtrirjen e sistemit të gjurmimit IPS në rang kombëtar e ndërkombëtar nëpërmjet PostNet e GS, përfshirja në IPS të programit të llogarive ndërkombëtare dhe reklamacioneve;
- zhvillimin e qëndrueshëm në proceset e zhvillimeve teknologjike, si:
 - o shtrirjen e mëtejshme të informatizimit të shërbimeve;
 - o automatizimin e sporteleve të shërbimit;
- zgjerimin e prezencës së kutive postare.

Sigurimi i shërbimeve cilësore dhe mbrojtja e përdoruesve është një kërkesë për të gjithë ofruesit e shërbimeve postare si publike dhe private dhe për të gjitha llojet e shërbimeve (universal ose jo). Ofruesit e shërbimeve postare duhet të përshtatin procedura të thjeshta dhe jo të kushtueshme për përdoruesit dhe ankesat e tyre, në veçanti në rastet e humbjes së dërgesave, vjedhjes, dëmtimit të tyre apo mosrespektimin e standardeve të cilësisë së shërbimit. Përdoruesit duhet të jenë të garantuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, si dhe marrjen e rimbursimit dhe/ose kompensimit në rastet e dëmtimit humbjes së objektit postar.

Në veçanti ofruesi i shërbimit postar universal duhet të sigurojë informacion të detajuar të përditësuar mbi shërbimin, kushtet e aksesit çmimet dhe nivelin e cilësisë. Përdoruesit kanë të drejtë të ankohen pranë autoritetit rregullator për cilësinë e shërbimit. Çdo operator/ofrues i shërbimeve postare duhet të raportojë mbi numrin e ankesave gjatë vitit dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre.

IV.9 Zhvillimi i burimeve njerëzore

Zhvillimi i sektorit postar kërkon zhvillimin e burimeve njerëzore nëpërmjet trajnimeve të stafit në aplikimin e teknologjive të reja, për të zotëruar risitë në zonat kyçe të veprimtarive postare. Forcimi i kapaciteteve të sektorit postar për t'iu përgjigjur nevojave për ndryshime në treg dhe përmirësimi i kualiteteve të burimeve njerëzore në sektorin postar do të jetë në vëmendje të vijueshme. Qeveria do të mbështesë dhe do të nxisë çdo iniciative për zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin postar.

Respektimi i kushteve të ndershme të punës është esencial. Shumë shtete anëtare të BE-së kanë zhvilluar rregulla të reja në lidhje me kushtet e punës (Gjermania) për të mbrojtur operatorin kombëtar incumbent. Kjo është duke ndryshuar nën presionin e madh të Komisionit European.

Është e rëndësishme të nënvizojmë që direktiva e tretë postare nuk është kundër parimit për fiksimin e një page minimale, por më shumë që kjo pagë minimale duhet të jetë ndershmërisht e vendosur midis të gjithë ofruesve postarë dhe bashkimeve tregtare.



AKEP-i dhe qeveria shqiptare duhet të sigurojë zhvillimin e kushteve të ndershme të punës megjithatë, është esenciale që këto nuk përdoren të ngadalësojnë zhvillimin e konkurrencës së ndershme në tregun postar.

IV.10 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në realizimin e objektivave të zhvillimit global, do të ndiqen dhe do të merret pjesë në aktivitetet dhe programet e miratuara nga Kongresi i UPU-së, Doha 2012. Në tabelën e mëposhtme jepen programet, aktivitetet e parashikuara sipas objektivave për periudhën 2012-2017 që do të koordinohen nga UPU.

Objektivat	Objektivi 1: Përmirësimi i ndërveprimit të rrjeteve ndërkombëtare postare	Objektivi 2: Sigurimi i njohurive teknike dhe ekspertizës në lidhje me sektorin postar	Objektivi 3: Promovimi i produkteve dhe shërbimeve të reja (zhvillimi i rrjetit tredimensional)	Objektivi 4: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit postar
Programet sipas objektivave	Rritja e cilësisë së shërbimit, si dhe besueshmërisë, si dhe efikasitetit të rrjeteve postare	Modernizimi dhe reformimi i sektorit postar	Modernizimi dhe diversifikimi i produkteve dhe shërbimeve postare	Përmirësimi i sistemit të shpërbimit ndërmjet operatorëve/ofruesve të caktuar postar
	Rritja e integritetit dhe sigurisë postare	Trajnime të stafit në aplikimin e teknologjive të reja, për të zotëruar risitë në zonat kyçe të veprimtarive postare	Lehtësimi ndërkombëtar i tregtisë elektronike	Forcimi i kapaciteteve të UPU-së për t'iu përgjigjur nevojave për ndryshim në treg
	Stimulimi i përdorimit të informacionit dhe teknologjive të komunikimit për të përmirësuar aksesin dhe performancën	Implementimi i metodave të dhe modeleve të menaxhimit për vlerësimin e produktit	Stimulimi i rritjes së tregut nëpërmjet përdorimit të teknologjive të reja	Nxitja për përfshirje të të gjitha segmenteve të popullsisë përmes qasjes më të madhe dhe /ose në shënjestër të shërbimeve postare
	Zhvillimi i përshtatshëm i standardeve dhe rregulloreve	Zhvillimi i bazuar në rezultatet dhe parimet e menaxhimit	Zhvillimi i vazhdueshëm i rrjeteve postare nëpërmjet 3D	Nxitja e ndërgjegjësimit mjedisor dhe përgjegjësisë sociale
	Promovimi i adresuar në sistemet kombëtare postare	Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet operatorëve/ofruesve të caktuar		
		Përdorimi i sektorëve potencial shkencor për zhvillimin dhe zbatimin e shërbimeve të reja postare		

V. Instrumentet e implementimit dhe monitorimit

Zbatimi i këtij dokumenti politikash do të ndiqet nga ministri dhe AKEP-i përkatësisht për çështjet e lidhura me kuadrin ligjor dhe atë rregullator postar.

Ministri nëpërmjet strukturave të varësisë, si dhe në bashkëpunim me AKEP-in dhe aktorë të tjerë do të punojë për rishikimin e kuadrit ligjor të sektorit postar dhe përmbushjen e angazhimeve në kuadër të procesit të integritetit me BE-në, si dhe të anëtarësimit në organizmat ndërkombëtarë si UPU dhe CEPT.

AKEP-i do të punojë për plotësimin e kuadrit të nevojshëm rregullator në zbatim të legjislationit, si dhe për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve nga operatorët/ofruesit e tregut postar.

Monitorimi i zhvillimit të tregut postar do të përfshijë ndjekjen e ecurisë së treguesve statistikorë të mbledhur dhe përpunuar nga AKEP-i mbi infrastrukturën postare, volumin e shërbimeve postare, respektimin e standardeve të cilësisë së shërbimit, respektimin e kërkesave për mbrojtjen e përdoruesve etj. Gjithashtu, monitorimi i zhvillimit të këtij tregu do të ndiqet dhe përmes publikimeve periodike të UPU-së për situatën e zhvillimit të tregut postar në rajon dhe në botë.

Zbatimi i këtij dokumenti në planin financiar lidhet me kostot e nevojshme për hartimin e kuadrit të ri ligjor në përputhje me *acquis communautaire* dhe për krijimin e kapaciteteve të nevojshme strukturore të rregullatorit dhe politikëbërësit.

Për sa i përket strukturës së nevojshme në AKEP për rregullimin postar, ajo është një kërkesë e domosdoshme për përmbushjen e duhur të detyrave rregullatore për tregun postar. Nga pikëpamja e impakteve financiare ajo është pjesë e parashikimeve në buxhetin e institucionit.

Rishikimi i kuadrit të përgjithshëm për realizimin e shërbimit universal postar kërkon në një fazë të dytë pas hapjes së plotë të tregut, një analizë të hollësishme të skemës së vijimësisë të ofrimit të këtij shërbimi. Në aspektin e investimeve të sektorit privat, nuk ka implikime të drejtpërdrejta financimi, ky dokument hap mundësinë e shtrirjes dhe zgjerimit të shërbimeve të ofruara nga sektori privat me hapjen e plotë të tregut dhe heqjen e zonës së rezervuar.

ANEKSI 1

KALENDARI I PROPOZUAR PËR ZBATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKËS

1	Hartimi nga ministri përgjegjës dhe miratimi i ligjit të ri për shërbimet postare për transpozimin e plotë të direktivave 97/67/EC, 2002/39/EC dhe 2008/6/EC	Fundi 2013
2	Zona e rezervuar (ndryshimi nga 100 g në 50 g)	Fundi 2013
3	Heqja e zonës së rezervuar	Fundi 2014
4	Krijimi i strukturës së rregullatorit postar përgjegjës vetëm për sektorin postar në Shqipëri	Brenda vitit 2013
5	Rishikimi dhe rishqyrtimi i standardeve të USO në Shqipëri. AKEP/GoA	Fundi 2013
6	Transparenca të dhënave të kostos dhe llogaritë e Posta Shqiptare. Sigurimi që tarifat për çdo shërbim në detyrimin e shërbimit universal janë përshtatur me koston	Fundi 2014
7	Sigurimi që AKEP të jetë i kompletuar si duhet për të përmbushur me efikasitet detyrat e tij. Sfida kryesore për AKEP do të jetë rregullimi i ndëroperimit në një treg me shumë operatorë/ofrues, marrja e iniciativave/veprimeve kundër pengesave për hyrjen në treg duke siguruar që tarifat janë përshtatur me koston	Fundi 2014
8	Zhvillimi i mëtejshëm i shërbimeve të postës hibride. Hyrja në tregje të afërt përmes zhvillimit të shërbimeve IT për klientët e tyre	Fillimi 2015
9	AKEP do të monitorojë dhe rregullojë aksesin në disa mjete/facilitete të infrastrukturës postare dhe mundësisht aksesin "Downstream" (aksesi nga palë të tretë të infrastrukturës së operatorit kryesor incumbent, veçanërisht në lehtësirat e përpunimit dhe shpërndarjes)	Fundi 2014
10	AKEP të llogarisë/studiojë koston neto të shërbimit universal në Shqipëri. Studimi i detajuar i kostove dhe përfitimeve të ndryshme të elementeve USO	Fundi 2014



VENDIM
Nr. 626, datë 30.7.2013

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE TË AKORDUARA NËPËRMJET MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONA VE RURALE (FAZA 2)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10 080, datë 23.2.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale (faza 2)””, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të akorduara nëpërmjet marrëveshjes së huas dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi i furnizimit me ujë i zonave rurale (faza 2)”, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONA VE RURALE (FAZA 2)
KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

Aneks 3

Aktivitetet e Programit	Financimi (EUR)		
	Shuma totale	Huaja e Bashkëpunimit Financiar	Kontributi lokal
1. Investim Fizik			
1.1 Ndertimi dhe Rehabilitimi i rreth 10 skemave te furnizimit me uje	1,341,871	1,131,871	210,000
1.2 Sherbime inxhinierike lokale per projektim dhe supervizion	147,170	147,170	
1.3 Kosto Administrative te ADF	110,000	35,000	75,000
1.4 Konsulent Nderkombetar Zbatimit	126,000	126,000	
1.5 Fond rezerve	59,959	59,959	
Kosto Totale	1,785,000	1,500,000	285,000

*konvertuar me normen e kembimit 1 EUR=120 Lek
- vit baze per parashikimin e kostove: 2008
- gjitha vlerat neto ndaj taksave

VENDIM
Nr. 627, datë 30.7.2013

PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE TË AKORDUARA NËPËRMJET MARRËVESHJES SË HUAS, FINANCIMIT DHE PROJEKTIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) DHE KfW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PROGRAMI RURAL I FURNIZIMIT ME UJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9883, datë 28.2.2008 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i fuqizimit me ujë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rishpërndarjes së fondeve të akorduara nëpërmjet marrëveshjes së huas, financimit dhe projektit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit “Programi rural i furnizimit me ujë”, sipas tabelës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROGRAMI I FURNIZIMIT ME UJË I ZONAVE RURALE
KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

Aneks 3

Aktivitetet e Programit	Financimi (EUR)		
	Shuma Totale	Huaja e Bashkëpunimit Financiar	Kontributi lokal
1. Investim Fizik			
1.1 Ndertimi dhe Rehabilitimi i 40-50 skemave të furnizimit me ujë	6,797,413	5,797,413	1,000,000
1.2 Sherbime inxhinierike lokale për projektim dhe supervizion	577,070	577,070	
1.3 Kosto Administrative të Përgjithshme të ADF	560,000	185,000	375,000
1.3.1 Kosto e Studimeve teknike të fizibilitetit, ADF	70,000	70,000	
1.4 Konsulent Nderkombëtar Zbatimit	593,950	593,950	
1.5 Fond rezerve	276,567	276,567	
Shuma e ndërmjetme I	8,875,000	7,500,000	1,375,000
2. Aktivitete të tjera të Projektit			
2.1 Sherbime konsulence për fuqizim institucional	1,000,000	1,000,000	
Shuma e ndërmjetme II	1,000,000	1,000,000	
Kosto Totale	9,875,000	8,500,000	1,375,000

*konvertuar me normën e këmbimit 1 EUR=120 Lek
- vit baze për parashikimin e kostove: 2006

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 7.8.2013
Doli nga shtypi më 7.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 40 lekë